Punëtor Magazine

– me kohë të plotë
– paradite

KOMBINAT – TIRANË
Adresa: Rr Llazar Xhajanka Nr 14, Nj. Adm. Nr 6

Rreth BNT Electronics
Themeluar në vitin 1994, ne jemi një nga kompanitë kryesore të teknologjisë në Shqipëri, me gamë të gjerë zgjidhjesh inovative për Sisteme Fiskale, Software, IT, Printera dhe Fotokopje, si dhe Sisteme Mjekësore.
Ofrojmë shërbime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë kombëtare duke i kthyer teknologjitë e avancuara në vlerë të shtuar për klientët tanë.
Me mbi **70** punonjës dhe një rrjet prej rreth **110** partnerësh që shtrihet në të gjithë vendin, ofrojmë ekspertizë të certifikuar dhe suport me në qendër klientin.

Jemi duke kërkuar një punëtor magazine
që do t'i bashkohet ekipit tonë të logjistikës.

Në këtë rol, Ti do të kesh përgjegjësinë për të zhvendosur mallrat në magazinë, sa herë ka shkarkime mallrash të sapoardhura dhe kur vijnë kërkesa për nxjerrjen e mallrave nga magazina.

Detyrat kryesore:

- Kryen shkarkimin e mallrave pa shkaktuar vonesa dhe dëme.
- Kontrollon etiketat e mallrave për përputhshmërinë me urdhër-porosinë.
- Sistemon mallrat nëpër vendet e paracaktuara.
- Përgatit mallrat për dalje nga magazina sipas kërkesës.
- Ngarkon mallrat në mjetet tërheqëse.
- Mban rregull dhe pastërti në magazinë.
- Paketon/Shpaketon mallra sipas nevojës.
- Merr pjesë në inventarët e magazinës

Aftësitë e kërkuara:

- Forcë fizike për të ngritur pesha.
- Të zbatojë rregullat dhe të respektojë eprorin.
- Të përmbushë detyrat në kohë.
- Bashkëpunues me kolegët.
- Me rigorozitet përmbush normat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
- Përdor me lehtësi transpaletën ose makinën pirun.
- Zhvendos mallrat me saktësi.

Kualifikimet bazë:

- Të ketë mbaruar shkollën e mesme.
- Dëshmi aftësimi për përdorimin e pirunit ngritës.

Ofrojmë punësim sipas Kodit të Punës me pagë konkurruese dhe 22 ditë pushimi vjetor të paguara. Mjedis pune stimulus dhe ekip bashkëpunues.

Mirëpresim aplikim tënd për punë!

Telefono **+355689296231**